



Pranuar / Dorezuar Primjenol/Prodato Received/Delivery	13.03	3	viti god year
Organ /Njësia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKP/SHK	2599/2023		114



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.65/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.65/2023 të datës 13.01.2023 të parashtruar nga ankuesi me adresë rruga në Prishtinë, kundër organit të punësimit/Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 13.03.2023 mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.65/2023 e datës 13.01.2023 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi sipas shkrësive të lëndës është i punësuar në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës, me datë 13.01.2023 ka parashtruar ankesë në protokollin 256/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër mos vazhdimit të kredencialeve të inspektorit nga Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 24.01.2023 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës. Këshilli më datë 03.02.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 22.02.2023 ka nxjerrë Vendimin me Nr. Port: 1984/2023, përmes të cilit, ankesës së ankuesit ia ka vazhduar afatin e vendimmarrjen lidhur me këtë çështje ankimore edhe për dhjetë (10) ditë pune.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova:* Ankesën me numër protokolli 256/2023 të datës 13.01.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Emailin e datës 30.12.2022 nga L.K për B.U dhe ankuesin; Emailin e datës 30.12.2022 nga B.E; Emailin e datës 27.12.2022 nga S.S për B.E; Emailin e datës 14.12.2022 për B.D, A.I, K.M, B.U dhe L.K; Emailin e datës 12.12.2022 nga B.E për S.S; Emailin e datës 05.12.2022 nga S.S për B.E; Manuali i Departamentit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Rregullimit Ekonomik të Aviacionit; Formular për Vlerësim për Inspektor për ankuesin i datës 19.12.2022; Kartelë për Kredencialet e Inspektorit për ankuesin; Manuali i Cilësisë; Letër përcjellëse e datës 27.12.2017; Rekomandimin për Emërimin e ankuesit në pozitë Inspektor i rregullimit ekonomik të aviacioni i datës 26.12.2017; Aplikacion për Kredenciale të Inspektorit datë 26.12.2017; Formular vlerësimi për inspektor i datës 26.12.2017; Certifikatën për ankuesin e datës 10.11.2017; Certifikatën për periudhën 03-07.03.2014; Certifikatën për periudhën 11-13.04.2012; Certifikatën për periudhën 27.02.2012 deri më datë 02.03.2012; Certifikatën për periudhën 20-24.02.2012; Plotësimin e ankesës e datës 30.01.2023; Emailin e datës 24.01.2023 nga B.U për B.E; Emailin e datës 23.01.2023 nga S.S për B.U; Emailin e datës 23.01.2023 nga B.U për S.S; Emailin e datës 18.01.2023 nga S.S për ankuesin; Emailin e datës 30.01.2023 nga L.K për ankuesin; Emailin e datës 27.01.2023, 18.01.2023 nga L.K për B.E; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datë 24.01.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 03.02.2023; Akt Emërimin e datës 30.11.2022 dhe 17.07.2012 për ankuesin; Vendimin me numër protokolli 1984/2023 të datës 22.02.2023 të Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit, *është e pabazuar, sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga shkresat e administruara të lëndës ka gjetur se ankuesi është i punësuar në pozitë *“Zyrtar I Lartë për Bashkëpunim Ndërkombëtar”* në Departamentin për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Rregullim Ekonomik të Aviacionit, në kuadër të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, i cili në bazë të kartelës ka pasur Kredencialet e Inspektorit nga sata 30.05.2022 deri më datë 31.12.2022.

Në bazë të formularit të vlerësimit për inspektor më datë 19.12.2022 nga Drejtori i Departamentit është propozuar për vazhdimin e kredencialeve për ankuesin, mirëpo Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, nuk ka bërë vazhdimin e kredencialeve për ankuesin me arsyetim që vazhdimi i kredencialeve të inspektorit mund të bëhet vetëm për Departamentit e SHNA, AGA dhe DSF ashtu siç parashihet edhe me manualin e cilësisë.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se në këtë proces ka pasur shkelje ligjore dhe procedurale sepse mos vazhdimi i kredencialeve është bërë në kundërshtim me Ligjin Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, Rregulloren

Nr.08/2011 për Autorizimet dhe Kredencialet e Inspektorëve dhe Udhëzimin Administrativ Nr.02/2011 për Procedurat e Lëshimit të Kredencialeve të Inspektorit.

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e Rregullores Nr. 08/2011 për Autorizimet dhe Kredencialet e Inspektorëve e cila në nenin 2, përcakton se: *“Kredenciale nënkupton: a) Llojin e kualifikimit të veçantë në lidhje me kompetencat e AAC-së i cili i jep bartësit të saj disa të drejta të caktuara dhe obligime në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, këtë Rregullore dhe apo b) Një kartelë plastike e lehtë e hollë e printuar mirë, me informata personale të inspektorit të AAC-së, të caktuara me këtë Rregullore dhe shtojcën e saj”*, ndërsa sipas Udhëzimit Administrativ Nr.02/2011 për Procedurat e Lëshimit të Kredencialeve të Inspektorit neni 2 ku përcaktohet se: *“Përkufizimet: Kredenciale – nënkupton: a) Llojin e kualifikimit të veçantë në lidhje me kompetencat e AAC-së, i cili i jep bartësit të saj disa të drejta të caktuara dhe obligime në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, Rregulloren Nr. 08/2011 për autorizimet dhe kredencialet e inspektorëve dhe këtë Udhëzim Administrativ; dhe/apo; Inspektor – nënkupton një nëpunës të AAC-së, të cilit i është akorduar ky titull pas plotësimit të disa kushteve të nevojshme të cilat janë përcaktuar në Rregulloren Nr. 08/2011 për autorizimet dhe kredencialet e inspektorëve dhe këtij Udhëzimi Administrativ, të cilit i jepet e drejta të kryejë detyra të veçanta mbikëqyrjeje të përcaktuara në Ligjin Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil dhe në akte nënligjore të lëshuara nga AAC në bazë të tij”*.

Kolegji i Këshillit, konstaton se dispozitat e Rregullores Nr.08/2011 për Autorizimet dhe Kredencialet e Inspektorëve, konkretisht neni 5, ka përcaktuar se: *“Drejtori i përgjithshëm është autoriteti aprovues për dhënien e kredencialeve. Departamenti i Administratës do të administrojë procesin e lëshimit dhe kontrollit të kredencialeve të lëshuara”* si dhe dispozitat e Manualit të Departamentit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Rregullimit Ekonomik të Aviacionit 2.7 Kualifikimet e Inspektorit: *“Punonjësi i ACC-së që kërkon kredencialet e inspektorit duhet të ketë një kontratë punësimi me një afat fillestar prej jo më pak se një vit, të posedojë diplomë universitare nga fusha ekonomike ose diplomë universitare në ndonjë fushë tjetër.....”*, dhe ka ardhur në përfundimin se kredencialet e inspektorëve e kanë kuptimin e dhënies apo njohjes të së drejtës për kryerjen detyrave të veçanta mbikëqyrjeje nën kushtet dhe kriteret e parapara për nëpunësit e Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës të cilët veçse e kanë të themeluar marrëdhënien e punës, ndërsa autoriteti aprovues sipas dispozitave të lartcekura ligjore është Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, si rrjedhojë për nëpunësit e këtij institucioni e të cilët nuk kanë akt emërim të Inspektorit, kredencialet janë me afat të caktuar, si rezultat i kësaj është në kompetencë të plotë të Drejtorit të Përgjithshëm që të vazhdoj apo jo kredencialet.

Ndërsa Kolegji i Këshillit, duke ju referuar Manualit të Cilësisë së Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, tek pika 7.2, ku përcaktohen inspektorët, është përcaktuar se: *“Pas përmbushjes së të gjitha kushteve të parashtruara në Rregulloren 08/2011 për Autorizimet dhe Kredencialet e Inspektorëve, në Udhëzimin Administrativ 02/2011 mbi Procedurat për lëshimin e kredencialeve të inspektorëve si dhe në Manualin e Brendshëm të Depërtimit (AACK/DSF/TL-MAN, AACK/AGA-MAN dhe AACK/SHNA.NSATRNG-MAN), Drejtori i Përgjithshëm lëshon kredencialet e inspektorit. Në AAC janë sistemuar, trajnuar dhe akredituar këto profile të inspektorëve: për Vlefshmëri Ajrore, për Operime të Fluturimeve, për Aviacion të Përgjithshëm, për Aerodrome dhe për Shërbime të Navigacionit Ajror”*. Rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, bazuar në këtë manual nuk përcaktohet lëshimi i kredencialeve për

profilet që nuk janë përcaktuar në të, ngase kredencialet janë parashikuar të lëshohen vetëm për departamentet DSF, SHNA dhe AGA, ndërsa

Bazuar në gjetjet e dhëna si më lartë, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, analizimit të akteve normative lidhur me funksionin, detyrat dhe kompetencat e Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, analizimit të dispozitave të ligjit material si dhe konstatimeve të pasqyruara si në arsyetimin e këtij vendimi, Kolegji i Këshillit në mbështetje të nenit 132 paragrafi 2 të Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative ku përcaktohet se: “Organi epror, me akt administrativ, do të refuzojë ankesën nëse ankesa është e papranueshme, apo është e pabazuar, në pikëpamjen e ligjshmërisë apo përshtatshmërisë”, konstaton se ankesa e ankuesit është e pabazuar në pikëpamje të ligjshmërisë, ngase dhënie e kredencialeve të inspektorit në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës, është në diskrecion të Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, duke u bazuar në dispozitat e lartcekura, ndërsa pretendimet e ankuesit janë të pabazuara.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të nenit 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.65/2023

**Avdyl BEKTESHI**

*[Signature]*  
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Malsore Gashi-BAJRAKTARI**

*[Signature]*  
Kryetare e Kolegjit

### Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.